

AKT NORMATIV
Nr. 7, datë 14.12.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 29/2023, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në pikën 1, të nenit 65, fjalët “... dhe jo më vonë se data 20 e muajit, që pason çdo 3-mujor për individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë.” zëvendësohen me “... dhe individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë të regjistruar për TVSH-në, dhe jo më vonë se data 20 e muajit, që pason çdo 3-mujor për individët e vetëpunësuar apo individët tregtarë, që nuk janë të regjistruar për TVSH-në.”.

Neni 2

Në nenin 69 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e”, “ë” dhe “f”, me këtë përmbajtje:

“e) Për të gjithë tatimpaguesit, të regjistruar para datës 31 dhjetor 2023, të cilët janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi fitimin, si edhe për ata që regjistrohen për herë të parë në vitin pasardhës, për efekt të periudhës tatimore 2024, do të përdoren formularët dhe përgjegjësitë tatimore, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;

ë) Parapagimet, sipas nenit 63, të këtij ligji, për kategoritë e personave, të cilët furnizojnë shërbime profesionale dhe janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga data 1 janar 2024, përjashtimisht për vitin 2024, llogariten bazuar në deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin të viteve paraardhëse, duke zbatuar normat tatimore të parashikuara në këtë ligj;

f) Deklarata e tatimit të mbajtur në burim, sipas nenit 57, të këtij ligji, do të zbatohet duke filluar nga periudha tatimore janar 2025. Për vitin 2024 do të përdoret deklarata sipas modelit ekzistues.”.

2. Në pikën 2, fjalët “... deri më 31 dhjetor 2023 ...” zëvendësohen me “... deri më 31 dhjetor 2024 ...”.

3. Në pikën 5, në fund të fjalisë shtohen fjalët “... , me përjashtim të shkronjave “e”, “ë” dhe “f”, të këtij neni, zbatimi i të cilave do të bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, deri në periudhën dhjetor 2024”.

Neni 3

Në nenin 72, pas fjalëve “... 1 janar 2024, me përjashtim të ...” shtohen fjalët “... neneve 22, 23, 24, pika 1, që shtrijnë efektet nga data 1 janar 2025, ...”.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 182/2023

Dale nga shtypi ne date 16.12.2023